

UDHËZUES PËR PLOTËSIMIN E FORMULARIT A1

Matura Shtetërore 2015

1. **Formulari A1** plotësohet online. Procedura e plotësimit do të bëhet sipas një udhëzimi të veçantë.
2. **Formularin A1** e plotësojnë vetëm maurantët e vitit shkollor 2014 – 2015.
3. Plotësimi i **Formularit A1** fillon në Portalin Qeveritar, dhe përfundon në Portalin Matura Online në shkollën që caktohet nga DAR/ZA.
4. Procesi i plotësimit të **Formularit A1** ndiqet nga një person i ngarkuar nga drejtoria e shkollës, që quhet “mbikëqyrës”.
5. Mbikëqyrësi pajiset me kodin përkatës të hyrjes në sistem. Vetëm pasi mbikëqyrësi fut kodin në sistem, mauranti mund të përfundojë plotësimin e **Formularit A1**.
6. Lista me të dhënat e marra nga plotësimi i formularëve printohet, nënshkruhet nga mauranti, mbikëqyrësi dhe vulolet nga drejtori i shkollës ku plotësohen formularët A1. Listat ruhen deri në përfundim të Maturës Shtetërore 2015.

I. TË DHËNA PERSONALE

Plotësohen nga mauranti.

- **Tek pika 1**, (numri personal i letërnjoftimit ID), mauranti shënon numrin e tij personal që ka në dokumentin e identifikimit.

Për të dhënat **2-5**, pasi mauranti bën plotësimin, sistemi bën verifikimin e tyre dhe nuk lejon të vazhdohet aplikimi, nëse ka pasaktësi.

- **Tek pika 6**, mauranti shënon në fushat përkatëse, numrin e telefonit dhe adresën e email-it, të cilat duhet të ruhen të pandryshuara deri në fund të Maturës Shtetërore 2015, me qëllim që ai (mauranti) të marrë informacion në faza të ndryshme të procesit. Nëse mauranti nuk ka telefon, ose nuk dëshiron të shënojë numrin e telefonit, atëherë shënon mbikëqyrësi numrin e tij të telefonit.
- **Tek pika 7**, shënohet X tek kutizat pranë Po ose Jo.

II. TË DHËNA SHKOLLORE

Të dhënat shkollore do të plotësohen në bashkëpunim me **mbikëqyrësin** e sallës ku bëhet aplikimi. Për plotësimin saktë të kërkesave të këtij grupimi, mauranti dhe mbikëqyrësi duhet të marrin informacion të saktë dhe të plotë për rubrikat përkatëse:

Plotësohen nga mauranti.

- **Tek pika 8**; (emri i qytetit/fshatit), mauranti shënon emrin e qytetit/fshatit ku ndodhet shkolla ku po studjon.

- **Tek pika 9;** (emri i shkollës ku studjon), maturanti shënon emrin e shkollës ku po studjon.

Plotësohen nga mbikqyrësi.

- **Tek pika 10,** mbikqyrësi plotëson emrin e DAR/Za-së përkatëse.
- **Tek pika 11,** (indeksi i profilit), mbikqyrësi zgjedh nga lista numrin dyshifror që i përket shkollës ku studion maturanti, sipas listës së miratuar nga MAS.
- **Tek pika 12,** (emërtimi i profilit) mbikqyrësi plotëson emrin e profilit/degës.
- **Tek pika 13,** mbikqyrësi plotëson klasën dhe paralelin e klasës ku po studjon maturanti.
- **Tek pika 14,** zgjidhet nga lista, gjuha e huaj që në planin mësimor të shkollës trajtohet si gjuhë e huaj e detyruar, në nivelin gjuhësor B1.

III. TË DHËNA LËNDORE

Plotësohen nga maturanti.

- **Tek pika 15,** maturanti zgjedh nga lista lëndët Z1 dhe Z2 që dëshiron të japë provim.
Zgjedhja e lëndëve Z1 dhe Z2 bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 1, datë 12.01.2015.
- Numri i lëndëve që do të zgjidhen duhet të jetë detyrimisht 2 (dy).
- Shuma e krediteve të dy lëndëve që zgjidhen, duhet të jetë jo më e vogël se 8 (tetë).
- Kur zgjidhet një lëndë bërthamë, nuk mund të zgjidhet e njëjta lëndë e thelluar (përfshijtur lëndët e detyruara).
- Maturanti ka të drejtë të zgjedhë gjuhën e huaj të cilën parapëlqen nëse e ka zhvilluar ose jo në shkollë, në nivelin gjuhësor B2.
- Maturantët e shkollave artistike mund të zgjedhin vetëm njërën nga lëndët e grupit II: “Vetëm për shkollat artistike”.
- Teoria profesionale është e zërthyer në profile sipas indeksit të shkollave. Maturantët e shkollave profesionale duhet të zgjedhin vetëm njërën nga lëndët me zgjedhje në grupin III “Vetëm për shkollat profesionale”, lëndën tjetër duhet ta zgjedhin nga grupi I “Për të gjitha shkollat”.